



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

CN.nr.102/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Beshir Islami, kryetar, Rustem Thaqi dhe Milena Gjeriq, anëtarë, në çështjen juridike përmbartimore të kreditorit N. "N." Sh.P.K të cilën e përfaqëson Blerim Prestreshi, avokat nga P., kundër debitorit N.T.P."Sh. ....", me seli në P., rr. "...", nr..., me bazë përmbartimi sipas titullit ekzekutiv, duke vendosur lidhur me kompetencën lëndore, në seancën e kolegjit të mbajtur më 22.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike, kompetente lëndore është Gjykata Themelore në Prishtinë -Departamenti i përgjithshëm, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, me aktvendimin E.nr. 40/14, të datës 18.02.2014, ka lejuar përmbartimin ndaj debitorit për pagesën e detyrimit sipas titullit ekzekutiv në lartësi prej 352.03€. Ndërsa, e njëjta gjykate me aktvendimin E.nr. 40/14, të datës 08.12.2016 është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbartimore, ndërsa lëndën e ka dërguar në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti i Përgjithshëm, e cila me aktvendimin Cp.nr. 139/17, të datës 20.02.2023, është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore për të vendosur në këtë çështje, ndërsa lënda i është dërguar Gjykatës Komerciale në Prishtinë, si gjykatë kompetente për të procedura në këtë çështje përmbartimore.

Dhomat e Shkallës së Parë të Gjykatës Komerciale, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt i saj përfaqëson çështje për vendosjen e së cilës kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente Gjykata Themelore Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për çështje ekonomike, me aktvendimin e vet, KPPP.nr. 1832/23, të datës 13.02.2024, ka hapur konfliktin e

kompetencës në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke konsideruar se nuk kemi të bëjmë me kompetencë të Gjykatës Komerciale por kemi të bëjmë me përmbarrimin e dokumentit në lejin e të cilit janë shfrytëzuar të gjitha mjetet e lejuara, ose edhe nuk ka asnjë mjet për tu shqyrtuar, gjatë shqyrtimit paraprak të lëndës gjeti se çështja e cila është objekt për vendosjen kjo gjykatë nuk ka kompetencë lëndore, por që për vendosjen e kësaj çështje është kompetente pikërisht Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i përgjithshëm.

Për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës. Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-s dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr. 08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Me vështrim në nenin 13 pika 1.1. të Ligjit Nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, parashihet se përveç tjerash "Gjykata Komerciale ka juridiksion ekskluziv vetëm në kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre; kontestet në lidhje me pengimin e posedimit në mes të shoqërive tregtare dhe kontestet në mes shoqërive tregtare lidhur me të drejtat sendore dhe për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate.

Nga shkresat e lëndës del se Gjykata Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Ekonomike duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lejuar përmbarrimin ndaj debitorit. Ndërsa kjo gjykatë, është shpallur jo kompetente për të vendosur në këtë çështje përmbarrimore, ndërsa lënda është dërguar pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti i përgjithshëm, e cila është shpallur jo kompetente dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës Dhomat e Shkallës së Parë – Departamentit për Çështje ekonomike, si gjykatë kompetente për të proceduar në këtë çështje përmbarrimore. Kjo gjykatë konsideron se nuk ka kompetencë për të vendosur për këtë çështje.

Gjykata Supreme e Kosovës e aprovon në tërësi vlerësimin ligjor se kompetenca e Gjykatës Komerciale në çështjet përmbarrimore është e rregulluar me nenin 13 të Ligjit nr. 08/L-15 për Gjykatën Komerciale, me të cilin në paragrafin 1, pika 1.2 përcaktohet se: "Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.2.: të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përmbarrimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate."

Me qenë se nuk kemi të bëjmë me mjetet juridike në procedure përbarimore, konform ligjit të aplikueshëm, Ligji nr. 04/1-139 për Procedurën Përbarimore (tutje: LPP) janë te përcaktuara në nenin 67, sipas të cilit në paragrafin 1 përcaktohet se: "Në procedurën përbarimore, mjetet e rregullta të goditjes janë: 1.1. Prapësimi dhe 1.2. Ankesa," ndërsa me nenin 68 të po të njëjtit ligj, përcaktohen se mjetet e jashtëzakonshme nuk lejohen përveç kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë në raste të parapara me ligj, duke u nisur nga fakti se në rastin konkret, lënda ka për objekt zbatimin e përbarimit sipas propozimit për përbarim të kreditorit, ndërsa nuk ka për objekt shqyrtimi mjetet juridike në procedurë përbarimore Gjykata Komerciale nuk ka kompetencë për vendosje në këtë çështje përbarimore.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përbarimore është Gjykata Themelore në Prishtinë, për faktin se palët në këtë çështje përbarimore pasi që është lejuar përbarimi, lënda ka qenë në gjykatën themelore dhe nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përbarimit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kalojë te përbaruesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP, andaj Gjykata Themelore në Prishtinë mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdojë në trajtimin e rastit ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e LPP-së. Në rastet kur kemi të bëjmë me zbatimin e përbarimit sipas propozimit të kreditorit në asnjë rast nuk mund të jetë kompetente Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, sepse e njëjta vendos vetëm lidhur me mjetet juridike që paraqiten ndaj lejimit të përbarimit dhe në rastin kur palët nuk kanë paraqitur mjet juridik (prapsim apo ankesë), në të gjitha këto raste kompetente për të gjykuar janë gjykatat themelore, varësisht prej kompetencës territoriale.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përbarimore, atëherë kjo çështje përbarimore do të ishte në kompetencë të Gjykatës Komerciale, nëse plotësohen kushtet e përcaktuar sipas Ligjit për Gjykatën Komerciale të cekur më lart, sepse Gjykata Komerciale ka kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, ashtu siç është përcaktuar me nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Andaj, duke u bazuar në nenin 5 pika 5 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore Gjykata Supreme e Kosovës pas shqyrtimit të legjislacionit të aplikueshëm për këtë çështje, gjeti se gjykatë kompetente lëndore për të vendosur sipas propozimit për përbarim është Gjykata Themelore Prizren-Dega në Suharekë-. Për të vendosur për këtë çështje lënda i dorëzohet Gjykatës Themelore në Prizren Dega në Suharekë.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.102/2024 datë 22.02.2024

Kryetari i kolegjit,

Beshir Islami